

Transformimi i Gjykatave të Krimeve të Rënda ende në proces: Muaji Shkurt afati përfundimtar ligjor për ngritjen dhe fuzionimin e Gjykatave të Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (KKKO)

- *Në rreth më pak se dy javë kohë Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) pritet të emërojë gjyqtarët në Gjykatat e Posaçme KKKO*

Muaji shkurt është afati i fundit ligjor për ngritjen dhe fuzionimin e Gjykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar (KKKO). Sipas parashikimeve ligjore brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor duhet të përfundojë emërimi i gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda si edhe të fillojë ushtrimi i kompetencave të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor u konstitua në datën 20 dhjetor 2018 dhe afati dymujor i emërimit të gjyqtarëve pranë Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar përfundon jo më vonë se data 20 shkurt 2019.

Gjyqtarët aktualë të Gjykatave të Krimeve të Rënda mund të kalojnë në Gjykatat e Posaçme nëse ata dhe familjarët e afërt të tyre pranojnë të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake. Gjyqtarët mund të emërohen gjithashtu përkohësisht në Gjykatën e Posaçme dy javë nga krijimi i KLGJ-së kur ndaj tyre ka filluar procesi i rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK).

Megjithëse procedurat për caktimin e përkohshëm të gjyqtarëve pranë Gjykatave të Posaçme KKKO kanë filluar nga KLGJ që në fund të muajit dhjetor 2018, dhe pavarësisht se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) ka filluar procedurat e rivlerësimit për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe të Apelit, ende nuk ka një vendim apo prononcim zyrtar lidhur me procesin e emërimit të përkohshëm të gjyqtarëve të Gjykatave të Krimeve të Rënda në Gjykatat e Posaçme. Ndër të tjera, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk ka publikuar ende data specifike për seancat dëgjimore të gjyqtarëve të Krimeve të Rënda. Aktualisht numri i këtyre gjyqtarëve që kanë kaluar vetting-un vazhdon të mbetet dy.

Ndërkohë, ashtu si edhe në rastin e [Këshillit të Lartë të Prokurorisë](#), edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përfunduar miratimin e strukturës organizative të institucionit, ku përfshihen numri i përgjithshëm i punonjësve dhe buxheti përkatës. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka parashikuar një strukturë të përbërë prej 144 punonjësish dhe një buxhet për vitin 2019 prej 272.171 mijë Lekë. [Relacioni](#) dhe [shkresa zyrtare](#) për miratimin e strukturës organizative dhe

buxhetit të institucionit i është dërguar në fund të muajit janar Kuvendit të Shqipërisë, i cili i ka përfshirë në [kalendarin e punimeve](#) për periudhën 11 shkurt – 1 mars 2019.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka një rol kryesor në procesin e transformimit të Gjykatës së Krimeve të Rënda, duke shërbyer fillimisht si organ emërtese për dorëzimin e deklaratave respektive të privatësisë dhe duke bërë më pas emërimin e gjyqtarëve të kësaj Gjykate. Gjithashtu KLGJ ushtron kompetenca kryesore në rastin e aplikimeve të gjyqtarëve të tjerë kandidatë për Gjykatat e Posaçme KKKO.

Emërimi i prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme tejkalon afatin e parashikuar ligjor brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë: Ri-shpallja e aplikimit zgjat procesin e ngritjes së PP

- *Shtyrja e fazës së parë të aplikimeve për anëtarë në Prokurorinë e Posaçme, qëllim për të nxitur aplikimin e prokurorëve të tjerë potencialë*

Shpallja e garës në 7 Janar 2019 për kandidimin e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme, u konsiderua një nga hapat më të rëndësishëm në funksion të krijimit të këtij institucioni. Gjatë dy javëve të para nga shpallja e thirrjes numri i aplikimeve ishte i ulët, duke patur parasysh që vetëm dy prokurorë Besnik Muçi dhe Klodian Braho shprehën interes për të qenë pjesë e strukturës së re të hetimit.

Megjithatë gjatë ditëve vijuese të tjerë kandidatë prokurorë kanë aplikuar për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme, duke e çuar numrin në 15. Pavarësisht [mendimeve ndryshe](#) për mos shtyrjen e aplikimeve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me përfundimin e afatit 30 ditor (6 Shkurt 2019) vendosi me 10 vota pro dhe 1 kundër një shtyrje 2 javore kohore të aplikimeve për Prokurorinë e Posaçme.

Në funksion të rezultateve që solli faza e parë e aplikimeve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë gjykoi se gjatë fazës së dytë si rezultat edhe i aktiviteteve ndërgjegjësuere, pritet të shprehin interes për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme edhe prokurorë të tjerë potencialë. Afati i ri i aplikimeve është data 21 Shkurt 2019, duke sjellë tashmë shtyrjen e emërimit të prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme, e parashikuar të përfundonte brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, por e cila sipas llogaritjeve do të sjellë krijimin e SPAK në [Qershor 2019](#).

	Prokurorët kandidatë për në Prokurorinë e Posaçme		Vendimi i KPK
1.	Vatë Staka	Drejtues/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër	Konfirmuar
2.	Dorina Bejko	Prokurore/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec	Nuk ka filluar rivlerësimi
3.	Besim Hajdarmataj	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
4.	Arben Kraja	Prokuror/Prokuroria e Përgjithshme	Konfirmuar
5.	Vladimir Mara	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
6.	Dritan Prenci	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
7.	Doloreza Musabelliu	Prokurore/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
8.	Eugen Beci	Drejtues/Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan	Në proces
9.	Edvin Kondili	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces

10.	Ened Nakuçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
11.	Anton Martini	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
12.	Shkelzen Cena	Prokuror/Prokuroria Dibrës	Në proces
13.	Behar Dibra	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
14.	Klodian Braho	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Në proces
15.	Besnik Muçi	Prokuror/Prokuroria e Krimeve të Rënda	Konfirmuar

* Lista e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, të cilët kanë aplikuar deri në datën 6 Shkurt 2019

Ashtu siç është sjellë në [vëmendje edhe më parë](#), pjesa më e madhe e prokurorëve, të cilët kanë aplikuar për të qenë anëtarë të Prokurorisë së Posaçme përbëhet nga prokurorë aktualë të Prokurorisë për Krime të Rënda, të cilët për shkak të përvojës profesionale konsiderohen si kandidatët më potencialë për këtë strukturë.

Pavarësisht se thujse për të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar në fazën e parë për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme ka filluar procesi i rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), vetëm 3 prej tyre janë konfirmuar tashmë në detyrë, ndërkohë që gjatë periudhës në vijim pritet të publikohen datat e seancave dëgjimore për të kryer vlerësimin e kandidatëve të tjerë. Këshilli i Lartë i Prokurorisë do ti kërkojë KPK-së rivlerësimin me përparësi për të gjithë kandidatët në Prokurorinë e Posaçme, të cilët presin ti nënshtrohen vetting-ut.

Konfirmimi në detyrë nga KPK për prokurorët, të cilët kanë shprehur interes për të qenë pjesë e PP, është një detyrim ligjor, të cilit do të duhet ti nënshtrohen të gjithë kandidatët. Në të njëjtën kohë detyrimi për tu konfirmuar në detyrë përbën një vlerësim të nevojshëm për emërimin përfundimtar të kandidatit në këtë organ.

Rastet e mundshme të mos konfirmimit të prokurorëve nga KPK do të sillnin vonesa serioze në ngritjen dhe funksionimin e Prokurorisë së Posaçme.

■ *Ri-shpallja e aplikimeve, proces që ka shoqëruar të gjitha organet e reja të sistemit të drejtësisë*

Mos konfirmimi në detyrë i një numri të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe prokurorësh si edhe kërkesat specifike të parashikuara për anëtarët e organeve të reja të drejtësisë, të tilla si kufizimi i privatësisë, duket se kanë sjellë mëdyshje tek prokurorët dhe gjyqtarët për të aplikuar në këto struktura. Si rezultat, krijimi i thujse të gjitha organeve të reja të drejtësisë ka kaluar vështirësi në përmbylljen e suksesshme të aplikimeve që në fazën e parë.

Përveç thirrjeve të disahershme për anëtarët jo-gjyqtarë dhe jo-prokurorë, vetë konstituimi i KLGJ-së dhe KLP-së pati vonesa edhe si rezultat i ri-shpalljes së thirrjeve për anëtarët gjyqtarë dhe prokurorë. Nevoja për të përfunduar rivlerësimin e tyre nga KPK, mori gjithashtu kohën e nevojshme.

Megjithatë, edhe tashmë kur Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë kanë filluar ushtrimin e kompetencave të tyre në drejtim të krijimit dhe funksionimit të Gjykatave të Posaçme dhe Prokurorisë së Posaçme, duket se mungesa e vullnetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të kontribuar në institucionet më të rëndësishme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar mund të rrezikojë mbarvajtjen eficiente të këtyre organeve.

Për këto arsye, sikurse edhe në rastin e aplikimeve për KLGJ dhe KLP, vëmendja e aktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë ndaj procesit nuk ka munguar. Vetë drejtuesi i Delegacionit të BE në Tiranë i [ka inkurajuar prokurorët](#) të tregojnë interes dhe të aplikojnë për të qenë pjesë e strukturës së Prokurorisë së Posaçme. Gjithashtu edhe ekspertë pranë Ambasadës së SHBA në Shqipëri të cilët asistojnë në çështjet kundër korrupsionit kanë inkurajuar prokurorët të aplikojnë duke e [konsideruar](#) momentin e ngritjes dhe aplikimit në Prokurorinë e Posaçme dhe Byronë Kombëtare të Hetimit si një nga proceset më të rëndësishme historike të vendit.

Ndërkohë mbështetja financiare e Bashkimit Evropian me një buxhet prej [34 Milion €](#) për tre vitet e ardhshme si edhe ardhja në Shqipëri për një periudhë 2 vjeçare e një prej prokuroreve më me përvojë të rajonit Tamar Laptosh, theksojnë rëndësinë e përmbushjes së objektivave të reformës, ku përfshihen edhe ngritja dhe funksionimi i organeve të reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

KLJGJ dhe KLP shpallin vendet vakante për gjyqtarë dhe prokurorë: Shkolla e Magjistraturës hap aplikimet për 50 magjistratë të rinj gjatë vitit akademik 2019-2020

Plotësimi i vendeve vakante dhe nevoja për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj, në kushtet kur procesi i vetting-ut ka sjellë mos konfirmimin e një numri të konsiderueshëm të tyre, kanë sjellë marrjen e masave respektive nga Shkolla e Magjistraturës, organi kryesor për përgatitjen e magjistratëve të rinj.

Në këtë mënyrë, Shkolla e Magjistraturës ka vendosur gjatë mbledhjes së Këshillit të saj Drejtues në datën [29 Janar](#) shpalljen e vendeve vakante për magjistratë dhe kandidatë për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë për vitin akademik 2019 – 2020.

Shkolla ka nxjerrë dy vendime kryesore bazuar mbi numrin e kandidatëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe [Këshillit të Lartë të Prokurorisë](#), specifikisht Vendimin Nr. 17, datë 29.1.2019 “Mbi numrin e kandidatëve që do të pranohen në Programin e Formimit Fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019 – 2020” të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Vendimin Nr. 21, datë 28.1.2019 “Për caktimin e Numrit Maksimal të Kandidatëve për Prokurorë në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2019 – 2020”, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Shpallja e vendeve vakante dhe njoftimi i procesit të konkurrimit gjatë muajit [prill 2019](#) janë konsideruar si të rëndësishme edhe nga vetë [Kryetari](#) i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si pasojë jo vetëm e nevojës së sistemit të drejtësisë për magjistratë të rinj, por në mënyrë të veçantë për ngritjen e institucioneve të drejtësisë.